

Statuti i Bankës ProCredit SH.A. Kosovë

(i ndryshuar dhe i rishkruar)

**Aprovuar në Takimin e Jashtëzakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme e
Aksionarëve e ProCredit sh.a. Kosovë, më 16 gusht 2017**

Përmbajtja

Pjesa I - Emri, statusi juridik, zyra kryesore dhe qëllimi	3
Pjesa II - Afarizmi në të cilin do të angazhohet banka	4
Pjesa III - Kapitali dhe aksionet.....	6
Pjesa IV - Aksionarët - Të drejtat dhe obligimet	9
Pjesa V - Organet e bankës	10
Pjesa I - Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve	10
Pjesa II - Bordi i drejtorëve	15
Pjesa III - Bordi menaxhues	20
Pjesa IV - Komisionet.....	25
Pjesa VI - Përfaqësimi i bankës.....	26
Pjesa VII - Dispozita të ndryshme.....	27
Pjesa VIII - Dispozitat përfundimtare	29
ANEKSI 1 - Logo e bankës 29	31
ANEKSI 2 - Aktivitetet e mëposhtme nuk financohen:	32
ANEKSI 3 - Bordi i Drejtorëve (informata të përgjithshme).....	34
ANEKSI 4 - Kapitali aksionar dhe aksionarët.....	35
ANEKSI 5 - Lista e aktiviteteve - sipas klasifikimit të Agjencionit për regjistrimin e bizneseve në Kosovë.....	36

Pjesa I - Emri, statusi juridik, zyra kryesore dhe qëllimi

Neni 1 - Statusi juridik

1. Banka ProCredit në Kosovë, Sh.A. (shoqëria aksionare) (në tekstin e mëtejshëm: "Banka"), është bankë komerciale, e organizuar si shoqëri aksionare dhe detyrimet e aksionarëve janë të kufizuara sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Banka është person juridik. Të drejtat dhe obligimet e bankës përcaktohen me këtë statut (i quajtur "Statuti"), Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123, Ligji për Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare Nr. 04/L-093, rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe të gjitha instrumentet tjera ligjore të zbatueshme, dhe rregulloret sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës, dhe sipas ndryshimeve të tij.

Neni 2 - Firma, stema dhe vula

1. Banka e ka emrin e vet zyrtar, vulën dhe stemën, si dhe rekuizitat tjera përkatëse të saj.
2. Banka kryen aktivitetet e veta afariste me emrin "ProCredit Bank, Sh.A." (firma).
3. Në të gjitha rastet kur përdoret emri i bankës në formë të shtypur ose të shkruar, emrit do t'i paraprijë stema, dizajni i së cilës është dhënë në Aneksin 1 të këtij dokumenti.
4. Banka ka vulën e rumbullakët të kompanisë dhe vulën katrore të datës. Të dyja këto përmbajnë emrin dhe stemën e bankës. Vula e bankës dhe vula e datës mund të përmbajnë edhe stemën dhe adresën e zyrës kryesore të bankës ose në rastin e vulës së kompanisë dhe vulës së datës së degës, stemën dhe adresën e degës në fjalë. Vulat regjistrohen te autoritetet e duhura.

Neni 3 - Selia dhe adresa

Zyra e regjistruar e bankës ndodhet në adresën Rrugën Xhorxh Bush 26, 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Neni 4 - Pjesëmarrja në format e shoqërimit

1. Banka mund të operojë me një rrjet që përbëhet nga degët, vartësit dhe personat e ndërlidhur dhe zyrat e përfaqësimit në Kosovë dhe jashtë saj.
2. Banka mund të marrë pjesë në kompani, konsorciume dhe forma tjera të shoqërimit që i mundëson ligji.

Neni 5 - Objektivat e bankës

1. Objektivi i bankës është të kryejë transaksione bankare dhe të ofrojë shërbime financiare dhe shërbime dhe transaksione tjera të lidhura me këto, ku përfshihen përvetësimi, mbajtja dhe tjetërsimi i interesave në ndërmarrje tjera. Në aktivitetet e saj të huadhënies, banka do të ofrojë kredi në radhë të parë për ndërmarrjet e vogla, por jo ekskluzivisht vetëm për to, duke i dhënë kontribut në këtë mënyrë zhvillimit ekonomik të Kosovës.
2. Banka mund të realizojë objektivat e veta përmes kompanive të shoqëruara në Kosovë dhe jashtë saj si dhe përmes pjesëmarrjes në ekuitet.

Neni 6 - Viti kontabël, valuta dhe parimet

1. Viti fiskal i bankës korrespondon me vitin kalendarik. Përbëhet nga dymbëdhjetë muaj, duke filluar nga 1 janari dhe përfundon më 31 dhjetor.
2. Banka do t'i përgatisë pasqyrat financiare vjetore në bazë të valutës Euro.
3. Parimet kontabël të bankës, dhe në këtë bazë edhe pasqyrat financiare periodike të bankës do të jenë në pajtim me standardet e kontabilitetit në Kosovë dhe me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (në tekstin e mëposhtëm të quajtura: SNRF-të).

Neni 7 - Dispozita tjera të përgjithshme

1. Firma dhe stema, bashkë me selinë dhe adresën e bankës, si dhe të dhënat tjera që kërkohen me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës do të vendosen në të gjitha dokumentet që i nxjerr banka.
2. Ekzistenca e bankës nuk është e kufizuar në kohë.
3. Banka ka pronën e saj dhe mund të marrë pjesë në transaksione juridike me emrin e saj, të marrë të drejta pronësore dhe të drejta jo-pronësore, të marrë mbi vete obligime, dhe të jetë paditës ose i pandehur në gjykatë, në gjykatë arbitri ose në forum ndërmjetësimi.
4. Banka ka gjendjen e vetë të bilancit, ka të drejtë të hapë llogari pagese dhe lloje tjera të llogarive (duke përfshirë edhe llogaritë në valutë të huaj) në Kosovë dhe në shtetet tjera.

Pjesa II - Afarizmi në të cilin do të angazhohet banka

Neni 8 - Aktivitetet

1. Banka realizon aktivitetet e saj në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123, Ligjin për Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare Nr. 04/L-093, dekretet, rregullat dhe rregulloret tjera të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, procedurat e dokumentuara administrative dhe të kontabilitetit, kushtet, konditat dhe kufizimet që kërkohen për licencat e bankave, të gjitha instrumentet tjera ligjore të zbatueshme dhe rregulloret sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës, të ndryshuara si dhe këtë statut. Nëse nuk ka rregullore në fuqi apo dekret të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për aktivitete specifike bankare, banka do të veprojë në pajtim me praktikat ndërkombëtare të bankave, me miratimin paraprak të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

2. Në pajtim me licencën e lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, banka ofron shërbime të kredihënies, financiare, të pagesave, parave dhe shërbime tjera bankare, duke përfshirë të mëposhtmet, përveç tjerash:
- a. Pranimi i depozitave me interes dhe pa interes (sipas kërkesës, të afatizuara dhe tjera) dhe instrumente tjera të kthyeshme të pagesës;
 - b. Mbajtja e llogarive dhe pasurive financiare;
 - c. Dhënia e kredive, duke përfshirë pa kufizime kreditë afariste, hipotekare, konsumuese dhe llojet tjera të kredive, financimin e tregtisë, lëshimin e garancive, letërkredive dhe fletëve të pranimit;
 - d. Huamarrja e fondeve dhe blerja apo shitja për llogari të veten ose për llogari të klientëve e të mëposhtmeve:
 - i. Instrumentet e tregut të parave;
 - ii. Letrat me vlerë të borxheve;
 - iii. Kontratat e të së ardhmes dhe opsionale për shitblerje të letrave me vlerë të borxheve ose me normat e interesit; ose
 - iv. Instrumentet e normave të interesit;
 - e. shitblerja e instrumenteve monetare për bankën dhe për klientët e bankës (duke përfshirë pa kufizime çeqet, letërpremtimet dhe certifikatat e depozitave), letrave me vlerë, kontratave të së ardhmes, instrumenteve opsionale, dhe instrumenteve të shkëmbimit me instrumente të borxhit ose norma të interesit, valutave, instrumenteve të normave të interesit, instrumenteve të borxhit, instrumenteve të valutës së huaj, metaleve të çmueshme dhe gurëve të çmuar;
 - f. realizimi i transaksioneve në para dhe atyre jo-në para, shërbimet e inkasimit të parave;
 - g. lëshimi dhe qarkullimi i mjeteve të pagesës (fletëpagesat, çeqet dhe kambialet);
 - h. ndërmjetësimi për para (duke përfshirë edhe valutat e huaja);
 - i. qiradhënia;
 - j. shërbimet e depozitimit të sigurtë;
 - k. shërbimet e ndërmjetësimit në tregje financiare;
 - l. shitblerja e valutës së huaj, duke përfshirë edhe transaksionet që përfshijnëkontratat e të ardhmes që mbahen vetëm për zvogëlim të riskut të normës së interesit ose riskut të shkëmbimit të valutës;
 - m. shërbimet e mirëbesimit, duke përfshirë pa kufizime investimin dhe administrimin e fondeve që mbahen në mirëbesim;
 - n. shërbimet e informimit për kredi;
 - o. shërbimet që lidhen me të gjitha aktivitetet e dhëna më lart;
 - p. të gjitha llojet tjera të aktiviteve bankare realizimi i të cilave lejohet për bankën me ligjet e Republikës së Kosovës.

Lista e aktiviteve sipas listës së klasifikimit të Agjencionit të Regjistrimit të Biznesit në Kosovë është dhënë në Aneksin 6.

3. Kur i kryen aktivitetet e veta, banka është e obliguar të respektojë limitet ekonomike dhe standardet ekonomike të vendosura nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
4. Banka duhet t'i respektojë rregullat dhe rregulloret e parapara me legjislacionin bankar në Republikën e Kosovës lidhur me mbajtjen e interesave të ekuitetit nga banka në personat tjerë juridikë.

Neni 9 - Përjashtimet

1. Në asnjë mënyrë nuk i lejohet bankës që të financojë biznese që angazhohen në ndonjë nga aktivitetet e ndaluara të identifikuara në listën e aktiviteteve të ndaluara, që është bashkëngjitur si aneksi 2 i këtij statuti.

Pjesa III - Kapitali dhe aksionet

Neni 10 - Kapitali i aksionarëve

1. Shuma totale e autorizuar e kapitalit të aksionarëve të bankës është ajo që është dhënë në aneksin 4.
2. Aksionet mund të jepen për para të gatshme. Ato mund të jepen edhe për kompensim tjetër vetëm nëse ky lloj kompensimi aprovohet nga 75% ose më shumë të aksionarëve dhe nëse respektohen procedurat që i parasheh ligji në fuqi lidhur me vlerësimin e kompensimit.

Neni 11 - Aksionet

1. Aksionet e zakonshme të bankës kanë vlerën e njëjtë nominale në shumë prej EUR 5 për aksion, dhe aksioni mund të ndahet në bazë të miratimit paraprak të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve. Aksionet e zakonshme kanë të drejta të barabarta.
2. Aksionet që i lëshon banka janë të regjistruara dhe të pa-certifikuara dhe regjistrohen në regjistrin e aksioneve siç është përcaktuar në Nenin 13.
3. Aksionet e zakonshme numërohen nga aksioni numër 1 deri në numrin e lëshuar.
4. Aksionet nuk do të lëshohen në çmim më të ulët se vlera e tyre nominale. Nëse aksionet lëshohen në vlerë më të lartë se vlera nominale, vlera e tejkualuar pas mbulimit të shpenzimeve të lëshimit të aksionit, do t'i shtohet rezervës ligjore ose një rezerve speciale.
5. Vetëm aksionet që janë paguar plotësisht do të u lëshohen aksionarëve.
6. Nëse një aksionar nuk i paguan bankës shumën lidhur me aksionet e tij/saj në ditën e caktuar për pagesë, aksionet përkitazi me të cilat duhet të paguhet shuma do të ofrohen për aksionarët tjerë në proporcion me aksionet që i mbajnë ata në kapitalin total të lëshuar të aksioneve.
7. Sipas ligjit për shoqëritë tregtare, banka nuk mund të ndihmojë në financimin e blerjes së aksioneve të veta nga një palë e tretë, dhe as të financojë blerjen e tillë.
8. Banka mund të blejë prapë deri në 10% të aksioneve të lëshuara të saj nga aksionarët, me kusht që t'i përmbahet disa procedurave sipas Ligjit për shoqëritë tregtare dhe Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare Nr. 04/L-093.

Neni 12 - Transferi i aksioneve

1. Aksionet do të transferohen në pajtim me ligjet në fuqi, dhe sipas kufizimeve në marrëveshjet e aksionarëve që mund të kërkojnë që opsioni i parë t'i jepet aksionarëve ekzistues.
2. Bankën do ta njoftojë shitësi i transferit të aksionit të regjistruar si dhe do të japë dëshmi për transferin.
3. Banka do të regjistrojë transferin e pronësisë pa pagesë dhe pa kufizime brenda tri ditësh nga pranimi i dëshmisë për transfer të aksioneve.

Neni 13 - Regjistri i aksioneve

1. Banka do të mbajë regjistrin e aksionarëve dhe të regjistrojë në të informatat në vijim:
 - a. Emrin dhe adresat e aksionarëve;
 - b. Datën në të cilën aksionari është regjistruar si aksionar;
 - c. Numrin e aksioneve që i posedon aksionari;
 - d. Datën në të cilën personi ka pushuar së qeni aksionar; dhe
 - e. Deklaratën e aksioneve që i mban secili aksionar, duke dalluar secilin aksion me numër të vet.
2. Regjistrin e aksioneve do ta mbajë sekretari i kompanisë ose një regjistruer i pavarur të cilin e autorizon banka, i cili është i obliguar t'i regjistrojë të gjitha ndryshimet në pronësinë e aksioneve.
3. Çdo aksionar i bankës ka të drejtë ta kontrollojë regjistrin dhe mund të kërkojë një kopje të regjistrit, ose një pjesë të tij, me pagesë të arsyeshme, dhe banka do t'i dërgojë kopjen e kërkuar brenda 5 ditësh duke filluar nga dita që vijon pas ditës në të cilën kërkesa është pranuar nga banka.
4. Përveç nëse është urdhëruar nga një gjykatë kompetente, ose nëse është kërkuar me ligjin në fuqi ose me këtë statut, asnjë person banka nuk do ta pranojë se mban aksione të mirëbesim, dhe banka nuk do të jetë e obliguar as e detyruar në asnjë mënyrë për të njohur interesat e ekuitetit, interesat në të ardhmen ose interesat e pjeshme në aksione, dhe as të drejtat tjera lidhur me ndonjë aksion përveç të drejtës absolute për tërë aksionin që e mban aksionari i regjistruar.
5. Sa i përket bankës, personi mund të konsiderohet si aksionar vetëm nëse ai/ajo është regjistruar në regjistrin e aksioneve.
6. Nëse sipas opinionit të bankës, një person është regjistruar gabimisht si aksionar në regjistrin e aksioneve, banka mund ta anulojë regjistrimin nëse më parë i ka njoftuar personat në fjalë për anulimin e tillë, dhe u ka dhënë një periudhë të arsyeshme kohore për të kundërshtuar.

Neni 14 - Rritja e kapitalit të aksionarëve

1. Kapitali i autorizuar i bankës mund të rritet me vendim në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve.
2. Bordi i drejtorëve mund të propozoj tek aksionarët të rrisë kapitalin e lëshuar të aksionarëve brenda limiteve të kapitalit aksionar të autorizuar.
3. Njoftimi për aksionarët duhet të japë arsyet e rritjes, shumën e rritjes së propozuar, një draft të ndryshimeve të këtij statuti lidhur me rritjen, një shpjegim të numrit të aksioneve plotësuese që do të

lëshohen ose të rritjes në vlerën nominale, datat e propozuara të fillimit dhe përfundimit të periudhës së blerjes së aksioneve plotësuese dhe detajet e periudhës si dhe aranzhimet për ushtrim të të drejtave preferenciale të blerjes së aksioneve sipas nenit 15 më poshtë.

Neni 15 - Të drejtat preferenciale të aksionarëve

1. Përveç nëse vendoset ndryshe në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve me rezolutë për të rritur kapitalin e autorizuar aksionar dhe përveç në lidhje me aksionet që lidhen me skemën e aksioneve të një punëtori, secili aksionar do të ketë të drejtë që me kërkesë të blejë aksione të reja në proporcion me aksionet që i mban në kapitalin e lëshuar ekzistues të aksioneve. Një periudhë prej jo më pak se dy javësh do të jepet për të ushtruar të drejtat e tilla të blerjes së aksioneve (në tekstin e mëposhtëm është quajtur “Periudha e blerjes së aksioneve”). Nëse një ose më shumë aksionarë nuk e shfrytëzojnë këtë të drejtë të blerjes së aksioneve, këta aksionarë do të kenë të drejtë të blejnë aksionet e palëshuara në proporcion me aksionet e tyre totale që i mbajnë për deri në një vit pas datës kur janë ofruar aksionet, ose periudhë më të shkurtër kohore siç është vendosur në rezolutën fillestare të aksionarëve, me kusht që çmimi i tyre i blerjes të mos jetë më pak se 100% të çmimit që është autorizuar fillimisht dhe që i është ofruar aksionarëve që nuk janë blerës të aksioneve.
2. Çdo aksionar që ka për qëllim të ushtrorë të drejtën e tij/saj për blerje të aksioneve siç është dhënë në paragrafin e mësipërm në këtë nen do të ofrojë njoftim me shkrim (në tekstin e mëposhtëm i quajtur “njoftimi për blerje të aksioneve” duke shprehur qëllimin e tij te kryesuesi i bordit të drejtorëve brenda periudhës së blerjes së aksioneve të paraparë në paragrafin (1) të këtij neni. Kryesuesi i bordit të drejtorëve do të sigurojë që blerësit e aksioneve të reja të marrin konfirmimin e blerjes brenda një jave nga fundi i periudhës së blerjes më së voni. Konfirmimi i blerjes do të specifikojë numrin e aksioneve që i janë ndarë çdo blerësi të aksioneve të reja dhe të dhënat për pagesë që kërkohen për të kryer pagesën.
3. Pas regjistrimit të aksioneve të reja në regjistrin e aksioneve banka do të regjistrojë secilin aksionar, numrin e aksioneve të cilat do t'i blejë ai, dhe të gjitha informatat tjera që kërkohen me ligj në regjistrin e aksioneve, si dhe të ofrojë dëshmi të këtyre të aksionarët e tillë.

Neni 16 - Zvogëlimi i kapitalit të autorizuar aksionar

1. Kapitali i autorizuar i bankës mund të zvogëlohet me rezolutë në Mbledhjen e Përgjithshme të aksionarëve. Rezoluta do të parashohë nëse një pjesë e kapitalit të aksioneve duhet të paguhet.
2. Çdo zvogëlim i kapitalit të autorizuar duhet të aprovohet nga Banka qendrore e Republikës së Kosovës dhe duhet të veprohet sipas procedurave lidhur me njoftimin publik sipas Ligjit për shoqëritë tregtare.
3. Kapitali aksionar mund të zvogëlohet me:
 - a. Zvogëlim të vlerës nominale të aksioneve;
 - b. Anulimin e aksioneve të cilat në datën e aprovimit të kësaj rezolute nuk janë marrë ose nuk është vendosur që të merren nga asnjë person, dhe zvogëlimin e shumës së kapitalit aksionar të bankës për shumën e aksioneve të anuluar.
4. Rendi i ditës, raporti dhe rezoluta duhet të parashohin në çfarë mënyre bëhet zvogëlimi i kapitalit.
5. Çdo rezolutë e miratuar sipas dispozitave të këtij neni do të komunikohet menjëherë me shkrim nga kryesuesi i Bordit të drejtorëve ose një avokat i autorizuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve

për ata aksionarë që nuk kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar si duhet në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve në të cilën është miratuar rezoluta e përmendur.

Neni 17 - Ndryshime tjera në kapitalin e aksionarëve

1. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të vendosë ta modifikojë ndarjen e kapitalit të autorizuar.
2. Çdo rezolutë e miratuar sipas dispozitave të këtij neni do të komunikohet menjëherë me shkrim nga Kryesuesi i bordit të drejtorëve ose një avokat i autorizuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve për ata aksionarë që nuk kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar si duhet në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve në të cilën është miratuar rezoluta e përmendur.

Neni 18 - Ndarja e profitit dhe e humbjeve

1. Humbjet do të mbulohen nga këto burime, dhe këto burime do të shfrytëzohen sipas këtij rendi:
 - a. Fitimet e mbajtura të bankës;
 - b. Rezervat vullnetare të bankës;
 - c. Rezervat ligjore të bankës;Nëse fitimet e mbajtura dhe rezervat e tilla janë të mjaftueshme për këtë qëllim.
2. Humbjet që nuk mund të mbulohen me fitime të mbajtura ose rezervat do të barten në vitin pasues.
3. Profiti vjetor pas tatimeve do të shfrytëzohet për këto qëllime dhe sipas këtij rendi:
 - a. Për të mbuluar humbjet e bartura;
 - b. Për të rritur ose rimbushur rezervat ligjore deri në shumën që kërkohet me ligj (nëse ka të tillë);
4. Profiti i mbetur pas tatimeve për një vit të dhënë do t'i nënshtrohet rezolutës së miratuar në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve, të bartet ose të ndahet në rezervat vullnetare ose të shpërndahet në formë dividende të aksionarët.

Pjesa IV - Aksionarët - Të drejtat dhe obligimet

Neni 19 - Të drejtat e aksionarëve

1. Aksionarët e bankës janë ata persona që i mbajnë aksionet e bankës me rregullat dhe rregulloret e vendosura dhe janë të regjistruar në regjistrin e aksioneve të bankës.

2. Të gjitha aksionet e zakonshme të bankës kanë të drejta të barabarta në pronësinë e tyre dhe aksionari i atij aksioni ka të drejtë të bëjë të mëposhtmet (me kusht që të ketë marrëveshje aksionari që mund të imponojë kufizime):
 - a. Të drejtën për të votuar në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve, me kusht që një aksion të llogaritet si një votë;
 - b. Të drejtën për të marrë dividendat e deklaruar në Mbledhjen e përgjithshme;
 - c. Të drejtën preferenciale për të blerë aksione të reja;
 - d. Të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e pasurive të bankës në rast likuidimi;
 - e. Të drejtën për të transferuar aksionet sipas ligjit;
 - f. Të drejtën për të parë bilancin e gjendjes së bankës, llogarinë e profitit dhe humbjes dhe regjistrin e aksioneve;
 - g. Të drejtën për të marrë materiale me shkrim lidhur me rendin e ditës së Mbledhjes së përgjithshme të aksionareve (që është përkufizuar më poshtë), ose për t'i shqyrtuar ato në zyrën kryesore të bankës;
 - h. Të drejtën për të marrë njoftim për Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe për të marrë pjesë dhe për të votuar në këtë mbledhje personalisht ose përmes përfaqësuesit.

Neni 20 - Obligimet e aksionarëve

1. Aksionarët e bankës do të kenë për obligim të japin kontribute që mbulojnë vlerën e lëshimit të aksioneve të blera me kushtet e specifikuar në këtë statut ose me rezolutë në Asambleshën e Përgjithshme.
2. Aksionarët e bankës duhet të veprojnë në pajtim me rregullat e përkufizuara në këtë statut.

Pjesa V - Organet e bankës

Neni 21 - Llojet e organeve

Organet e bankës janë:

- a) Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve ;
- b) Bordi i drejtorëve; dhe
- c) Bordi menaxhues.

Pjesa I - Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve

Neni 22 - Statusi dhe mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve është organi suprem i vendimmarrjes i bankës. Ai mban dy lloje të mbledhjeve: mbledhjet e zakonshme dhe mbledhjet e jashtëzakonshme.

Neni 23 - Mbledhjet e zakonshme të Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve

1. Mbledhjet e zakonshme të Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve do të mbahen të paktën një herë prenda një viti kalendarik, siç parashihet me ligjin në fuqi.
2. Mbledhja e zakonshme e Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve mbahet për të analizuar dhe diskutuar raportet për veprimet e përgatitura nga Bordi i drejtorëve dhe pa marrë parasysh të drejtat dhe obligimet tjera të parapara në ligjet në fuqi ose në status,
 - a. me shumicë votash që përfaqësojnë 90% të kapitalit të lëshuar të aksioneve, ka fuqinë ekskluzive për të:
 - i. Aprovuar shitjen e pjesëve të konsiderueshme të pasurive të bankës;
 - ii. Vendosur për ndryshime të statusit apo bashkim/blerje të bankës;
 - iii. Aprovuar fillimin ndonjë aktiviteti afarist që nuk është ai i bankave oseshërbimeve financiare përkatëse, ose drejtpërdrejt ose përmes një vartësi, me kusht që kjo nuk do të pengojë mbajtjen e interesit të ekuitetit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në atë masë sa është e nevojshme për zbatimin e kolateralit ose deri në atë masë sa është e duhur si pjesë e strategjisë së bankës për investime;
 - iv. Vendosur për bashkimin e bankës ose nëse duhet të kërkojë mbrojtjen e ligjeve për likuidim;

Ku aksionarët nuk do të pengojnë pa arsye miratimin e tyre për cilëndo nga çështjet e dhëna në nën-paragrafët nga (i) deri në (iv);
 - b. me shumicë votash që përfaqëson 75% të kapitalit të lëshuar të aksionarëve, ka autoritetin ekskluziv për të:
 - i. Vendosur për rritjet, zvogëlimet ose ndryshimet e kapitalit të autorizuar dhe vëllimit, llojit, datës dhe mënyrës së lëshimit të aksioneve të reja;
 - ii. Ndryshuar statutin dhe ligjet anësore ose marrëveshjen e kompanisë, të cilat janë nxjerrë më vonë;
 - iii. Përcaktuar udhëzimet e politikave të bankës dhe ndryshimet e tyre;
 - iv. Vendosur për transaksionet nga banka të cilat nuk janë në aktivitetet e zakonshme të punës së saj ose me kushtet e zakonshme komerciale ose në bazë të marrëveshjeve sipas tregut; dhe
 - v. Vendosur për përmbylljen e një partneriteti, marrëveshjeje për ndarje të profitit apo licenca ose marrëveshjeje të ngjashme nga banka, ku të ardhurat dhe profiti i bankës ndahen ose mund të ndahen me një palë të tretë;
 - vi. Vendosur për blerjen apo përvetësimin, lënien peng ose në hipotekë të të drejtave pronësore ose të drejtave tjera (përveç të drejtave të përmendura në paragrafin vii, më poshtë), vlera monetare e të cilave në datën e vendimit të bankës për të kryer transaksionin përfshin 50% ose më shumë të vlerës së librit të pasurive të bankës në bazë të bilancit të gjendjes të datës më të fundit të bankës; dhe
 - vii. vendosur për blerjen ose përvetësimin e pronës me vlerë kontabël në mes 15% (pesëmbëdhjetë) dhe 33% (tridhjetë e tre) të totalit të pronës ekzistuese të bankës, nëse transaksioni i tillë nuk është miratuar më parë me vendim unanim të Bordit të Drejtorëve.

dhe

- c. me shumicë të thjeshtë të votave të pranishme, ka autoritetin ekskluziv për të:
 - i. Aprovuar raportet financiare vjetore dhe raportin vjetor;
 - ii. Vendosur për ndarjen e profitit dhe mbulimin e humbjeve dhe pagesën e dividendëve;
 - iii. Vendosur se cili auditor i pavarur do të caktohet për të audituar pasqyrat financiare;
 - iv. Caktuar dhe larguar nga detyra anëtarët e Bordit të drejtorëve dhe për të vendosur nivelin e shpenzimeve që duhet të mbulojnë për anëtarët;
 - v. Ratifikuar veprimet e bordit të drejtorëve dhe shefit ekzekutiv; dhe
 - vi. Miratuar rezoluta tjera në pajtim me ligjet në fuqi, dhe rregullat tjera të brendshme sidhe marrëveshjet e bankës.
3. Kryesuesi i bordit të drejtorëve është përgjegjës për të organizuar dhe dërguar ftesa me shkrim ose njoftime me faks, email, postë të shpejtë ose letër rekomande për aksionarët për t'i njoftuar ata që të marrin pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve së paku 10 ditë para datës së mbledhjes. Kryesuesi e përcakton edhe rendin e ditës. Njoftimi i mbledhjes do të japë datën, orën dhe vendin e mbledhjes dhe do të përfshijë agjendën me dokumentacionin e duhur për të përfshirë detajet e kandidatëve për anëtarë të bordit, kopjen e raportit vjetor, pasqyrën e profitit dhe të humbjes dhe bilancin e gjendjes ku ato duhet të jenë të miratuara dhe një pasqyrë se kur dhe si do të dërgohen ato ose si do të vendosen në dispozicion për aksionarët para mbledhjes vjetore. Drejtori nuk mund të shkarkohet në mbledhje përveç nëse në njoftimin e mbledhjes theksohet se ky është qëllimi i mbledhjes. Gjithashtu, kërkohet që të njoftohet dhjetë (10) ditë para datës së mbledhjes me shpallje jo më pak se 10% të një faqeje në një gazetë që shpërndahet përgjithësisht në Kosovë në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze.
4. Si rregull, mbledhja e zakonshme e Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve mbahet në objektin afarist të bankës. Me propozim të kryesuesit të bordit të drejtorëve megjithatë, mund të mbahet në ndonjë vend tjetër, duke përfshirë edhe jashtë Kosovës, mirëpo me kusht që ai vend të mos shkaktojë barrë të panevojshme te ndonjëri nga aksionarët.
5. Me qëllim të përcaktimit të së drejtës për të marrë njoftim për takim ose për të drejtës për të votuar, aksionarët përkatës do të jenë ata që janë regjistruar si aksionarë ose që kanë të drejtë të regjistrohen si aksionarë në një datë e cila është 30 ditë para datës së caktuar të takimit ("Data e regjistrimit").

Neni 24 - Mbledhja e jashtëzakonshme e Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve mbahet nëse ka kërkesë me shkrim që kërkon të mbahet ajo mbledhje dhe dorëzohet nga shumica e anëtarëve të bordit të drejtorëve ose nga aksionarët që mbajnë në total 75% të të drejtave të votës. Kërkesa me shkrim duhet të dorëzohet te Kryesuesi i bordit të drejtorëve më së pak se 10 ditë para datës së propozuar të mbledhjes dhe duhet të përfshihet edhe rendi i ditës, data, koha dhe vendi i mbledhjes. Bordi i drejtorëve do të marrë vendim për t'u mbledhur ose për të refuzuar mbledhjen brenda 5 ditësh pas pranimit të kërkesës. Refuzimi për të mbajtur mbledhjen duhet të theksojë arsyet e refuzimit, dmth nëse kërkesa për takim është bërë nga numri

- i duhur i personave që mbajnë përqindjen e duhur të votave ose nëse asnjë nga çështjet në rendin e ditës nuk janë brenda kompetencave të aksionarëve.
2. Mbledhja e jashtëzakonshme e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve ka të njëjtat fuqi si edhe mbledhja e zakonshme e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve, përveç se nuk mund të miratojë rezolutë që aprovon pasqyrat financiare, raportin financiar ose ndarjen e profitit dhe mbulesën e humbjeve.
 3. Kryesuesi i bordit të drejtorëve është përgjegjës për të dërguar ftesat me shkrim përmes faksit, emailit, postës së shpejtë ose letrës rekomande për aksionarët për të marrë pjesë në Mbledhjen e jashtëzakonshme të Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve më së pak se dhjetë (10) ditë para datës së mbledhjes, dhe për të vendosur për rendin e ditës. Pa marrë parasysh fjalinë e mësipërme, mbledhja e jashtëzakonshme e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve mund të mbahet në çdo moment pa ftesë me shkrim ose me njoftim për një kohë më të shkurtër, siq parashihet në nenin 24.4 të Ligjit për Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare Nr. 04/L-093, nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm ose janë përfaqësuar dhe ata vendosin njëzëri që ta mbajnë këtë mbledhje. Njoftimi i takimit duhet të japë datën, orën dhe vendin e mbledhjes dhe të përfshijë edhe dokumentacionin përkatës.
 4. Vetëm çështjet brenda rendit të ditës bën të diskutohen në mbledhjen e jashtëzakonshme të përgjithshme, përveç nëse të gjithë aksionarët që kanë të drejtë vote janë të pranishëm ose të përfaqësuar dhe pajtohen unanimisht për të diskutuar apo vendosur për çështje tjera.
 5. Me qëllim të përcaktimit të së drejtës për të marrë njoftim për të mbledhje ose të drejtës për të votuar, aksionarët përkatës do të jenë ata që janë regjistruar si aksionarë ose që kanë të drejtë të regjistrohen si aksionarë në një datë e cila është 30 ditë para datës së dërgimit të njoftimit për mbledhje ("Data e regjistrimit").
 6. Si rregull, mbledhja e jashtëzakonshme e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve mbahet në objektin afarist të bankës. Me propozim të kryesuesit të bordit të drejtorëve megjithatë, mund të mbahet në ndonjë vend tjetër, duke përfshirë edhe jashtë Kosovës, mirëpo me kusht që ai vend të mos shkaktojë barrë të panevojshme te ndonjëri nga aksionarët dhe që kjo të jetë në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 25 - Përfaqësimi, kuorumi dhe të drejtat për votë

1. Aksionarët që janë persona juridikë mund të marrin pjesë në Mbledhjet e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve përmes një përfaqësuesi juridik të autorizuar si duhet. Çdo aksionar ose përfaqësues juridik i një aksionari që nuk është në gjendje të marrë pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve mund të caktojë një aksionar tjetër ose një palë të tretë që të ushtrorë të drejtat e tij ose saj të votës si përfaqësues. Njoftimi për delegimin e të drejtave të votës dhe të dhënat e emrit dhe identitetit të përfaqësuesit duhet t'i përcillen kryesuesit të bordit të drejtorëve në formë të një përfaqësimi me shkrim para Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve. Përfaqësuesi duhet të japë dëshmi të identitetit të vet atëherë kur merr pjesë.

Përfaqësuesi mund të theksojë se si votohen aksionet në takim. Nëse nuk e bën këtë atëherë përfaqësuesi mund t'i votojë aksionet sipas dëshirës së tij.

2. Kryesuesi dhe të paktën një anëtar i Bordit Menaxhues duhet të jenë prezent në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve.

3. Të drejtat e votës nuk mund t'i delegohen shefit ekzekutiv dhe as zëvendësve të tij ose saj, Menaxherëve të Lartë, auditorit të brendshëm ose punëtorëve të tjerë të bankës. Asnjë përfaqësues nuk bën të jetë valid për më shumë se gjashtë muaj. Aksionari mund të tërheqë emërimin e përfaqësuesit në çdo moment para se të jepet vota ose duke dorëzuar revokim me shkrim te kryesuesi ose duke marrë pjesë në mbledhje dhe duke votuar për aksionet e tij ose saj personalisht.

- 4 Gjatë Mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve, anëtarët e tij mund t'i bëjnë të njohura pikëpamjet e tyre ose gojarisht ose me shkrim. Në raste të jashtëzakonshme, në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve mund të miratohen rezoluta në bazë të votave të dorëzuara përmes postës ose faksit. Rregullat e detajuara për komunikimin e pikëpamjeve të anëtarëve dhe për votim mund të paraqiten në rregullat e procedurës së Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve të përcaktuara në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve
5. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve ka kuorum nëse aksionarët që përfaqësojnë më se dy të tretat e kapitalit të lëshuar të aksioneve janë të pranishëm ose janë përfaqësuar si duhet. Nëse brenda gjashtëdhjetë (60) minutave nga koha e caktuar për takim nuk është i pranishëm kuorumi, atëherë Mbledhja e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve, nëse mbahet me kërkesë të aksionarëve që përfaqësojnë më pak se pesëdhjetë përqind të të drejtave të votës, do të shpërndahet; në rastet tjera do të mbetet e mbyllur, dhe kryesuesi i bordit të drejtorëve do të përcaktojë datën specifike (që nuk mund të jetë më herët se pesëmbëdhjetë (15) dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës që fillimisht është caktuar për Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve), orën dhe vendin në të cilin do të mbahet mbledhja; nëse në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve të mbyllur dhe mandej të mbledhur prapë nuk është i pranishëm kuorumi brenda gjysmë ore nga ora e caktuar për mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve, atëherë aksionarët që janë të pranishëm do të formojnë kuorum. Kryesuesi i bordit të drejtorëve do t'i informojë të gjithë aksionarët pa vonesë për ndonjë shtyrje të mbledhjes së Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve.
6. Në takimet e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve, mbajtësit e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të japin nga një votë për secilin aksion të zakonshëm që e mbajnë. Përveç nëse parashihet ndryshe me dispozita të detyrueshme nga ligji ose me dispozitat e këtij statuti, rezolutat nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve kërkojnë shumicë të thjeshtë të votave të pranishme. Votat kumulative *nuk* do të zbatohen as për zgjedhje ose shkarkim të drejtorëve.
7. Votimi për zgjedhje ose shkarkim të drejtorëve do të jetë me votë të fshehtë. Votimi për çështjet tjera do të kryhet përmes fletëve të votimit megjithatë mund të bëhet me votë të fshehtë nëse kjo kërkohet nga kuvendi ose nga një ose më shumë aksionarë që mbajnë aksione që kanë të drejta për 20% ose më shumë vota që mund të hidhen për atë çështje.
8. Regjistri i aksionarëve do të jetë në dispozicion në takim për t'u lexuar.

Neni 26 - Kryesimi i mbledhjeve të Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve

1. Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve kryesohen nga Kryesuesi i bordit të drejtorëve ose ndonjë anëtar tjetër i bordit të drejtorëve i caktuar nga kryesuesi ose nëse kryesuesi i caktuar i Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve nuk është i pranishëm, nga një aksionar ose përfaqësues juridik i autorizuar i një aksionari i caktuar me shumicë të thjeshtë votash të aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar si duhet në mbledhjen e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve
2. Kryesuesi i Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve përcakton rendin sipas të cilit pikat e rendit të ditës do të diskutohen dhe mënyrën dhe formën në të cilën do të bëhet votimi përveç nëse parashihet ndryshe me rregullat e procedurës së Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve

Neni 27 - Procesverbalet e mbledhjeve të Mbledhjes e Përgjithshme të Aksionarëve

Duhet të hartohet një procesverbal me shkrim i substancës së të gjitha diskutimeve në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe të gjitha rezolutave të miratuara nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve dhe ky procesverbal duhet të nënshkruhet nga kryesuesi dhe ndonjë sekretar i mbledhjes që do të jetë përgjegjës që procesverbali të jetë i saktë. Procesverbali do të përfshijë emrin e bankës dhe adresën e zyrës qendrore, datën,

orën dhe vendin e takimit, rendin e ditës, kuorumin, fletëvotimin ose procedurat tjera që përdoren për votim, numrin e votave që i posedojnë aksionarët në takim, emrin e kryesuesit dhe sekretarit, çështjet për të cilat është votuar dhe rezultatet e votave, një përmbledhje të fjalimeve dhe diskutimeve, një listë të vendimeve të marra në takim, si dhe ndonjë kundërshtim nga ana e aksionarëve dhe anëtarëve të bordit të drejtorëve. Kryesuesi i mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve apo sekretari që mbanë minutat e takimit është përgjegjës për hartimin e procesverbalit i cili duhet të kryhet jo më vonë se 30 ditë prej datës së mbledhjes.

Neni 28 - Anashkalimi i njoftimit

1. Sa herë që kërkohet të jepet njoftimi me ligjin në fuqi dhe me këtë statut, anashkalimi i njoftimit i hartuar me shkrim dhe i nënshkruar nga personat që kanë të drejtë për atë njoftim do të konsiderohet se është ekuivalent me dhënien e njoftimit.
2. Nëse aksionari merr pjesë në mbledhje, kjo do të thotë që heq dorë nga kundërshtimi për mungesë të njoftimit ose për njoftim defekt të mbledhjes, përveç nëse aksionari në fillim të mbledhjes kundërshton shprehimisht mbledhjen për këto arsye.
3. Rezoluta e nënshkruar nga të gjithë aksionarët (në një ose më shumë dokumente) do të ketë të njëjtën fuqi si edhe rezoluta e mbledhjes së aksionarëve.

Neni 29 - Rendi i ditës

1. Aksionari ose aksionarët që mbajnë së paku 5% të të gjitha votave që kanë të drejtë të hidhen për votim për bordin e drejtorëve në mbledhjen vjetore do të kenë të drejtë të vendosin pika në rendin e ditës së çdo mbledhjeje si dhe të drejtën për të propozuar kandidatë për zgjedhje në mbledhjen vjetore të bordit të drejtorëve, numri i të cilëve nuk mund të tejkalojë numrin total të anëtarëve të bordit të drejtorëve. Të gjitha propozimet e tilla duhet të bëhen me shkrim, të përfshijnë emrat dhe numrat e votave të secilit propozues, dhe do t'i dorëzohen bankës, duke iu drejtuar bordit të drejtorëve të bankës në zyrën kryesore me email, postë të shpejtë ose faks, jo më vonë se 8 ditë para mbledhjes.
2. Të gjitha propozimet e tilla që i dorëzohen në mënyrën e rregullt bankës së paku 8 ditë para se të dërgohet njoftimi i mbledhjes do të përfshihen në njoftim dhe rend dite të mbledhjes, dhe propozimet që janë dorëzuar në mënyrën e rregullt pas kësaj kohe banka do t'ua dorëzojë menjëherë të gjithë aksionarëve të cilëve u është dërguar njoftimi fillestar.

Pjesa II - Bordi i drejtorëve

Neni 30 - Statusi dhe përbërja

1. Bordi i drejtorëve këshillon dhe mbikëqyr bordin menaxhues gjatë menaxhimit të bankës.
2. Anëtarët e bordit të drejtorëve zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve për një periudhë prej prej jo më shumë se katër (4) vitesh dhe mund të ri-zgjidhen. Bordi i drejtorëve ka numër tek të

anëtarëve voutes dhe do të përbëhet nga së paku 5 anëtarë. Shumica e këtyre anëtarëve duhet të jenë të pavarur, jo-drejtorë ekzekutiv dhe të paktën njëri nga ta duhet të jetë banor në Kosovë. Çdo drejtor ka nga 1 votë. Anëtarët e bordit duhet të jenë persona fizikë. Shefi ekzekutiv duhet të jetë anëtar i bordit pa të drejtë vote në pajtim me kërkesat e Ligjit për Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare dhe të Bankës Qendrore të Kosovës.

3. Anëtarët e bordit të drejtorëve janë
4. subjekt i aprovimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dheemrat e tyreduhet të regjistrohën në Regjistrin i cili mbahet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
5. Bordi i drejtorëve duhet të zgjedhë një kryesues nga anëtarët e tij.
6. Antarët e Bordit të Drejtorëve do të hijnë në mardhënie kontraktuale puneme bankën që janë subjekt i aprovimit nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve.
7. Antarët e tanishëm të Bordit të Drejtorëve janë të renditur në listë në Anëksin 3 më poshtë.

Neni 31- Detyrat dhe përgjegjësitë e bordit të drejtorëve

Detyrat specifike dhe përgjegjësitë e bordit të drejtorëve janë si në vijim:

- a. Të përcaktojë strategjinë afariste të bankës, strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të gjitha politikat e Bankës brenda kornizës së udhëzimeve të politikave siç është paraparë me Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe të marrë raporte nga zyrtarët, menaxhmenti ose komisionet lidhur me statusin e veprimtarisë së bankës dhe shpalosjet tjera që kërkohen me ligj, duke përfshirë edhe shpalosjen e informatave që janë të nevojshme për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- b. Të aprovojë planin vjetor të punës (duke përfshirë edhe buxhetin vjetor) dhe të monitorojë implementimin e tij;
- c. Të aprovojë strukturën e përgjithshme organizative të bankës përveç nëse ajo është aprovuar në mënyrë eksplicite në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve;
- d. Të hartojë propozime për ndryshime të statutit dhe udhëzimet e politikave që duhet të miratohen në Mbledhjet e Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve;
- e. Të emërojë, dhe nëse është e nevojshme, të zëvendësojnë shefin ekzekutiv, të lëshojnë udhëzime për aktivitetet e tij/saj, dhe të vendosë për kushtet e kontratës së punësimit të tij ose saj, si dhe të emërojë dhe të aprovojnë zëvendësit e shefit ekzekutiv, të nxjerrë udhëzime për aktivitetet e tyre, dhe të vendosë për kushtet e pagesës dhe kontratave të tyre;
- f. Të emëroj Menaxherët e Lartë dhe të vendosë për kushtet e pagesës dhe kontratat e tyre, bazuar në rekomandimet e Drejtorit Ekzekutiv
- g. Të përgatisë rekomandime dhe rendin e ditës për Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe përmes kryesuesit të tij, të mbajë mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve;
- h. Të propozojë dhe japë mandatin e auditorit të jashtëm që zgjidhet në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve, duke përfshirë edhe vendosjen e pagesës dhe kushteve;
- i. Të diskutojë dhe aprovojë raportet për aktivitetet afariste të bankës gjatë vitit financiar dhe të rishikojë dhe aprovojë pasqyrat financiare vjetore dhe raportin vjetor si dhe t'i dorëzojnë ato në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve;

- j. Të prezantojë të gjitha raportet e auditimit të jashtëm për Mbledhjen e ardhme të përgjithshme të aksionarëve;
- k. Të aprovojë dhe krijojë rregullat speciale të procedurës për komisionet e bordit të drejtorëve pjesërisht Komisionit për Auditim dhe Komisionit për Menaxhim të Riskut, si dhe kur kërkohen me rregullat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe rregullores bankare;
- l. Të miratojë nga Bordi Menaxhues për themelimin e komisionit për risk kreditor, komisionit të pasurive dhe detyrimeve, komisionit për menaxhim të riskut, komisionit për resurse njerëzore, komisionit kundër shpërlarjes së parave dhe komisioneve tjera nëse është e nevojshme, dhe të aprovojë rregullat dhe procedurat për punën e këtyre komisioneve. Bordi Menaxhues në çdarë do kohe mund të vendos për themelimin e komisioneve të tjera siç është e detajuar në Nenin 42 më poshtë.
- m. Të marrë të gjitha masat tjera të nevojshme ose të dëshirueshme për mbikëqyrjen efektive të zyrtarëve ekzekutivë, ashtu si është dhënë në detaje në këtë statut;
- n. Të bëjë ndryshime të statutit nëse ndryshimet do të rriteshin ndryshimet e mëparshme të statutit në një dokument të vetëm, ose të bëjë ndryshime tjera administrative ose të formës të cilat nuk ndikojnë në të drejtat e aksionarëve (në këtë rast kërkohet aprovimi nga aksionarët);
- o. Vendos për lëshimin e bondeve, garancive dhe letrave të konvertueshme;
- p. Vendos në parim për llojet e rifinancimit të bankës, qoftë përmes kredive, bondeve ose në ndonjë mënyrë tjetër, dhe në këtë mënyrë udhëzohet bordi menaxherial për t'i implementuar ato vendime;
- q. vendos për ekspozimin e kredive, të kryera apo të pazgjidhura të ose për përfitim të çdo individi të vetëm apo grup njerëzish të lidhur, që tejkalojnë ekuivalentin e 5 % të kapitalit të paguar të bankës plus rezervat dhe fitimet e mbajtura;
- r. aprovon të gjitha blerjet, shitjet, shkëmbimet, leasing dhe transaksionet tjera pronësore drejtëpërdrejtë ose përmes filialeve (ku është e aplikueshme) përgjatë vitit biznesor që janë të barabarta me ose kalojnë 10% (dhjetë) të kapitalit të bankës dhe aprovon transaksionet tjera që nuk janë brenda aktiviteteve të zakonshme afariste;
- s. Aprovon transaksionet ndërmjet bankës dhe zyrtarëve apo anëtarëve të bordit menaxherial të bankës kur tejkalojnë ekuivalentin e 0.15% të kapitalit të paguar të bankës plus rezervat dhe fitimet e mbajtura siç është dhënë në nenin 54 të këtij kapitulli dhe të cilat nuk janë të ndaluara me Ligjet e Republikës së Kosovës, të Bankës Qendrore të Kosovës ose me këtë statut;
- t. Implementon vendimet e marra në mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve qoftë vetë, qoftë duke udhëzuar bordin menaxherial siç kërkohet nga rasti i caktuar;

Neni 32 - E drejta për përzgjedhje dhe delegim

Anëtarët e Bordit të drejtorëve nuk kërkohet domosdoshmërisht të jenë aksionarë as përfaqësues ligjore të aksionarëve në bankë.

Neni 33 - Dorëheqja nga bordi i drejtorëve dhe posti i zbrazët

1. Çdo anëtar i bordit të drejtorëve mund të heqë dorë nga mandati i tij ose saj duke dorëzuar një deklaratë me shkrim për këtë te kryesuesi i bordit të drejtorëve ose një nga zëvendësit e tij ose saj, me paralajmërim një muaj, që mund të anashkalohet, me kusht që dorëheqja të mos hyjë në fuqi para njoftimit.
2. Posti i zbrazët te bordi i drejtorëve duhet të plotësohet në mbledhjen e radhës së aksionarëve dhe në ndërkohë bordi i drejtorëve do të punojë pa anëtarin që është larguar.
Nëse numri i drejtorëve bie në 3 ose më pak, atëherë drejtorët duhet të mbajnë një Mbledhje të përgjithshme të jashtëzakonshme me qëllim të zgjedhjes së anëtarëve tjerë të bordit të drejtorëve, të cilët duhet të miratohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Neni 34 - Rregullat e brendshme të procedurës së bordit të drejtorëve

Bordi i drejtorëve do të definojë rregullat e veta të brendshme të procedurës sipas neneve më poshtë.

Neni 35 - Kryesuesi i bordit të drejtorëve

Pas një takimi në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve në të cilin anëtarët e bordit të drejtorëve janë zgjedhur si duhet në pajtim me këtë statut, do të mbahet një mbledhje e bordit të drejtorëve në të cilën bordi i drejtorëve zgjedh me shumicë votash një nga anëtarët e tij që të shërbejë si kryesues i bordit të drejtorëve për kohëzgjatjen e mandatit të tij ose saj, dhe një ose më shumë zëvendës. Përzgjedhja mbikëqyret nga anëtari më i vjetër i bordit të drejtorëve. Nëse nuk është i pranishëm në një mbledhje të caktuar, atëherë një kryesues do të emërohet për atë mbledhje të caktuar.

Neni 36 - Kompensimi i anëtarëve të bordit

Anëtarët e bordit mund të marrin pagesë për kryerjen e detyrave të tyre. Shuma e një pagese të tillë dhe kushtet e angazhimit duhet të caktohen në kontratën e punësimit e cila duhet të nënshkruhet në mes të Anëtarëve të Bordit dhe Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve me qëllim të aprovimit, nga Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve. Anëtarëve te bordit do të iu kompensohen shpenzimet e udhëtimit. Shuma e kompensimit të shpenzimeve do të përcaktohet për çdo vit në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve.

Neni 37 - Mbledhjet e bordit dhe rezolutat

1. Mbledhjet e zakonshme të bordit të drejtorëve do të mbahen së paku një herë për çdo tre muaj dhe së paku një herë në vit njëra nga mbledhjet për çdo tre muaj duhet të mbahet në Kosovë. Kryesuesi i bordit të drejtorëve është përgjegjës për të dërguar ftesa me shkrim për anëtarët e bordit së paku 14 ditë para takimit, duke bashkëngjitur rendin e ditës së propozuar. Mbledhjet e jashtëzakonshme të bordit mund të thirren në çdo kohë me shkrim nga kryesuesi por duhet të jetë një njoftimi tre (3) ditësh me synim thirrjen e kësaj mbledhje; mbledhja e jashtëzakonshme e bordit gjithashtu mund të thirret në çdo kohë nëse së paku një e treta e anëtarëve të bordit të drejtorëve kërkojnë me shkrim që të thirret mbledhja e tillë, ose nga një anëtar individual i bordit nëse kryesuesi ka neglizhuar detyrën e tij ose saj që të mbajë mbledhje të rregullta. Bordi do të konsiderohet se ka kuorum kur tre anëtarë janë të pranishëm ose përfaqësohen si duhet nga dikush. Përfaqësuesit duhet të paraqiten me shkrim para takimit (përfaqësimi elektronik është i lejueshëm nëse përcillet me versionin origjinal dhe të nënshkruar). Kryesuesi i bordit të drejtorëve mundet (dhe nëse merr kërkesë korresponduese nga shumica e anëtarëve të bordit, ai do ta bëjë këtë) të

- ftojë persona tjerë që të marrin pjesë në takimet e bordit të drejtorëve dhe mund t'u japë atyre të drejta të flasin për pikat individuale të rendit të ditës në ato takime.
2. Rezolutat do të miratohen me shumicë të thjeshtë të atyre anëtarëve që janë të pranishëm ose të përfaqësuar si duhet, përveç rezolutave për të aprovuar planin vjetor të punës ose për të aprovuar strukturën e përgjithshme organizative të bankës ose për të aprovuar politikën afariste të bankës që do të kërkojnë shumicë prej 75% të votave të drejtorëve që janë të pranishëm ose të përfaqësuar në mënyrën e duhur;
 3. Pjesëmarrja e drejtorit në mbledhje do të konsiderohet si anashkalim i kërkesës për njoftim përveç nëse drejtori merr pjesë vetëm për të kundërshtuar dhe i kundërshton temës së mbledhjes ose merr pjesë për të dhënë argumente që mbledhja nuk po mbahet në mënyrë të ligjshme.
 4. Mbledhjet e Bordit të drejtorëve mund të mbahen në më shumë se një vend, duke u lidhur ndërmjet vete me audio konferencë ose video-konferencë, përderisa të plotësohen kushtet e mëposhtme dhe të pasqyrohen ato në procesverbalet përkatëse:
 - a. Kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të vërtetojë identitetin dhe të drejtën për të marrë pjesë të atyre që janë të pranishëm, do ta kryesojë mbledhjen dhe do të vërtetojë dhe deklarojë rezultatet e votimit;
 - b. Sekretari i mbledhjes duhet të mund të perceptojë në mënyrë adekuate ngjarjet gjatë mbledhjes; dhe
 - c. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutim dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, si dhe të lexojnë, pranojnë dhe dërgojnë dokumentet që lidhen me rendin e ditës (nëse ka të tilla).

Neni 38 - Procesverbalet e mbledhjeve të bordit

Kryesuesi i bordit të drejtorëve duhet të hartojë procesverbalin me shkrim të substancës së të gjitha diskutimeve në mbledhjet e bordit të drejtorëve, dhe të gjitha rezolutave të miratuara nga bordi i drejtorëve dhe ta shpërndajë të anëtarët tjerë të bordit brenda 10 ditësh të punës pas mbledhjes, duke përfshirë personat që kanë qenë të pranishëm, orën dhe vendin e takimit, rendin e ditës, çështjet e dorëzuara për votim dhe rezultatet e votave, duke përfshirë edhe emrat e drejtorëve që kanë votuar për dhe kundër ose që kanë abstenuar dhe vendimet e miratuara në mbledhje. Pas miratimit nga anëtarët e bordit, këtë procesverbal do ta nënshkruajë kryesuesi i bordit dhe sekretari i mbledhjes në mbledhjen vijuese të drejtorëve.

Neni 39 - Shkarkimi i anëtarëve të bordit të drejtorëve

Drejtori do të shkarkohet nga posti nëse ai:

- a. Pushon që qeni drejtor për shkak të ndonjë dispozite ligjore, instrumenti statusor ose dekreti;
- b. Falimenton ose bën ndonjë marrëveshje apo bashkohet me kreditorët e tij ose saj, në përgjithësi;
- c. Shkualifikohet me ndonjë ligj (duke përfshirë edhe ligjin e Republikës së Gjermanisë) ose burgoset ose dënohet për krim të rëndë;
- d. E humb arsyen,

- e. Mungon ose nuk përfaqësohet në mënyrën e duhur në më shumë se dy mbledhje të njëpasnjëshme të bordit të drejtorëve pa aprovimin e bordit të drejtorëve; ose
- f. Shkarkohet nga posti në pajtim me këtë statut.

Pjesa III - Bordi menaxhues

Neni 40 - Statusi dhe përbërja

1. Bordi menaxhues, anëtarët e të cilit caktohen nga bordi i drejtorëve, është përgjegjës për të menaxhuar bankën në mënyrë të pavarur dhe të ligjshme. Gjatë kësaj, bordi është i obliguar të veprojë për interesin më të mirë të bankës dhe merr përsipër të veprojë për të rritur vlerën e qëndrueshme të bankës. Ai e zhvillon strategjinë e bankës, e koordinon atë me bordin e drejtorëve dhe siguron implementimin e saj.
2. Antarë të Bordit menaxhues janë Shefi Ekzekutiv (SHE) dhe Zëvendës SHE (apo zëvendësat). Të gjithë anëtarët e Bordit menaxhues janë përgjegjës të barabartë për operacionet dhe detyrimet e bankës.
3. Banka do të përfaqësohet bashkarisht nga dy anëtarë të Bordit menaxhues. Në mungesë zyrtare të SHE apo Zëvendës SHE, Banka mund të përfaqësohet individualisht ose nga Shefi Ekzekutiv ose nga Zëvendës SHE respektivisht.
4. Kohëzgjatja në zyrën e Shefit Ekzekutiv do të jetë katër vjet, e cila mund të rinovohet pa asnjë kufizim për numrin e kohëzgjatjes. Shefi Ekzekutiv dhe Zëvendësi i Shefit Ekzekutiv nuk mund të emërohen pa miratimin paraprak të BQK-së.
5. Bordi menaxhues në ushtrimin e funksioneve ligjore dhe statutorë të tij, mbështetet nga njësitë organizative të specifikuar në skemën organizative e cila miratohet dhe ndryshohet nga Bordi i Drejtorëve në bazë të nevojave të ProCredit Bank Sh.A.

Neni 41 - Kriteret e kualifikimit

Askush nuk mund të emërohet si anëtar i bordit menaxhues ose Menaxher i Lartë, dhe nëse është emëruar do të shkarkohet, nëse ai ose ajo:

- a. nuk vepron sipas kriterëve për menaxhimin e bankës që i ka vendosur Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- b. është anëtar i bordit menaxhues të ndonjë banke tjetër komerciale, një institucioni jo-bankar për depozita ose ndonjë ndërmarrjeje tjetër;
- c. nuk ka të drejtë ta ketë postin e drejtorit sipas ligjeve në fuqi;
- d. ka falimentuar;

- e. është dënuar për krim ekonomik dhe dënimi nuk është shfuqizuar; është bashkëshort-e, fëmijë ose i afërt i një anëtari tjetër të bordit menaxhues.

Neni 42 - Detyrat dhe përgjegjësitë e bordit menaxhues

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e bordit menaxhues përfshijnë të mëposhtmet:
- a. Kryen aktivitetet e përditshme dhe të gjitha aktivitetet e bankës në pajtim me ligjin, statutin, kontratën përkatëse të punës, politikën afariste të përcaktuar nga bordi i drejtorëve dhe në pajtim me udhëzimet e politikave të vendosura në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve;
 - b. të mbajë marrëdhënie efektive me të, si dhe të siguroj informacionet mujore Bankës Qendrore të Kosovës, për zhvillimin e biznesit të Bankës (duke përfshirë: pasqyrat mujore financiare, raporte mbi situatën e likuiditetit, mjaftueshmërinë e kapitalit në përputhje me rekomandimet e Komitetit të Bazelit, ekspozimin e kredive, aseteve jo-qarkulluese, vëllimin e depozitave të klientëve në periudha);
 - c. Rishikon të gjitha pikat para se të vendosen në rend dite të Mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve ose mbledhjet e bordit të drejtorëve, të marrë të gjitha informatat e nevojshme, të përgatisë propozime dhe të hartojë rezoluta;
 - d. Shkëmben të gjitha informatat e rëndësishme vazhdimisht ndërmjet Mbledhjeve të përgjithshme të aksionarëve dhe bordit të drejtorëve;
 - e. Mbikëqyr kreditë, pagesat, financimin, shërbimet e parave, sigurinë, kontabilitetin dhe raportimin e parave dhe gjësendeve të vlefshme të bankës, kontrollet e brendshme dhe kontabilitetin, siguron që banka të ofrojë shërbime të duhura në interesat e klientëve dhe mbikëqyr aktivitetet tjera madhore të bankës;
 - f. Përgatit raportet tremujore për aspektet kryesore të veprimtarisë afariste të bankës dhe i prezanton këto raporte te bordi i drejtorëve;
 - g. Përgatit pasqyrat financiare vjetore dhe raportin vjetor që duhet t'i prezantohen bordit të drejtorëve;
 - h. të drejtojnë dhe të marrin pjesë në komisionet e ndryshme të Bankës sipas standardeve të brendshme të komunikimit dhe marrjes së vendimeve në komisionet përkatëse në përputhje me Termat e Referencës të komisioneve, si dhe me politikat në fuqi të Bankës;
 - i. Përgatit buxhetin vjetor dhe planin vjetor afarist për vitin tjetër financiar para fillimit të vitit financiar;
 - j. Përgatit raportet speciale me kërkesë të kryesuesit të bordit të drejtorëve;
 - k. Siguron realizimin e rezolutave të vendosura në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe të bordit të drejtorëve;
 - l. Kryen të gjitha detyrat tjera që i janë dhënë atij nga bordi i drejtorëve në pajtim me ligjet në fuqi dhe këtë statut dhe siguron që të realizohen veprimet afariste të bankës në mënyrën e duhur dhe në pajtim me ligjin;
 - m. Zhvillon politikat të cilat i aprovon bordi i drejtorëve dhe siguron që ato politika të zbatohen ;
 - n. Harton standarde, procedura, rregulla të zyrës dhe rregullore tjera, të cilat i aprovon bordi menaxhues dhe siguron që ato standarde, procedura, rregulla të zyrës dhe rregullore të zbatohen ;

- o. Vendos për autoritetet individuale dhe të përbashkëta të zyrtarëve të bankës për të dhënë kredi, dhe vendos për themelimin dhe kompetencat e një ose më shumë komisioneve të kredive në bankë (përveç për kreditë që tejkalojnë 5% të kapitalit të bankës të cilat duhet të aprovohen nga bordi i drejtorëve).
 - p. Vendos për themelimin e komisioneve, nëse është e nevojshme ose kërkohet me ligj ose rregulla ose rregullore të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe aprovon rregullat dhe procedurat për punën e komisioneve. Komisioni për Menaxhim të Riskut, komisioni për pasuritë dhe detyrimet, komisioni i përgjithshëm i riskut dhe komisioni për resurset njerëzore dhe komisioni kundër pastrimit të parave duhet të aprovohen nga bordi i drejtorëve (shih nenin 31.1 më lart). Komisioni i auditimit duhet të caktohet nga Bordi i Drejtorëve (shih nenin 47 më poshtë.);
 - q. Vendos për përzgjedhjen, shkarkimin, trajnimin dhe pagesën e personelit (me kusht që bordi menaxhues të jetë i obliguar të shqyrtojë rekomandimet e bordit të drejtorëve lidhur me disa menaxherë të lartë);
 - r. Ofron informata mujore për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për zhvillimin e afarizmit të bankës (duke përfshirë: pasqyrat financiare mujore, raportet për situatën e likuiditetit, nëse kapitali është i mjaftueshëm sipas rekomandimeve të komisionit të Bazelit, ekspozimin e kredive, pasuritë nga të cilat nuk ka fitim, vëllimin e depozitave të klientëve sipas kushteve);
 - s. Kontraktin të gjitha policat e sigurimit që kërkohen për veprimtarinë e bankës, ku këto polica duhet të blihen në të gjitha rastet nga kompani sigurimesh me reputacion të mirë ;
 - t. Mbikqyrë aktivitetet e rrjetit të degëve;
 - u. Plotëson kërkesat e parapara në këtë statut dhe në ligjet në fuqi.
2. Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të bordit menaxhues janë përcaktuara me këtë statut dhe rezolutat e bordit të drejtorëve të bankës.

Neni 43 - Detyrat dhe përgjegjësitë e shefit ekzekutiv

- 1. Shefi ekzekutiv është përgjegjës për ligjshmërinë e operacioneve të bankës dhe implementimin e strategjisë së biznesit të themeluar të bankës.
 - 2. Shefi ekzekutiv përfaqëson bankën dhe vepron si agjent i saj.
 - 3. Shefi ekzekutiv është përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, Bordit të Auditorëve dhe Bordit të Drejtorëve të bankës;.
 - 4. Shefi ekzekutiv organizon dhe menaxhon operacionet e bankës;
 - 5. Shefi ekzekutiv merr vendime në lidhje me qështjet të cilat nuk kanë nën juridiksionin e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, Bordit të Auditorëve apo Bordit të Drejtorëve të bankës; dhe
 - 6. Shefi ekzekutiv kryen të tjera funksionetë përputhje me ligjin, statutin e bankës dhe nenet e saja të përgjithshme.
- Shefi ekzekutiv mund të delegojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij të dhëna në pjesën e mësipërme te zëvendësi ose te zëvendësit e tij, sipas rastit.

Neni 44 - Struktura e gjerë organizative dhe ndarja e përgjegjësiave të anëtarët e bordit menaxhues

1. Bordi menaxhues vendos për strukturën e përgjithshme organizative dhe ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet afariste të anëtarët e bordit menaxhues. Bordi i drejtorëve duhet ta aprovojë strukturën e përgjithshme organizative dhe të jetë i informuar për planin për ndarjen e përgjegjësive dhe për ndryshimet e tij.
2. Anëtarët e bordit menaxhues kanë përgjegjësi të përbashkët për tërë menaxhimin e afarizmit të bankës. Ata punojnë së bashku në frymën e përgjegjësisë kolektive dhe e informojnë njëri tjetrin për të gjitha transaksionet e mëdha afariste dhe masat e marra në fushat e veta të përgjegjësisë. Megjithatë, çdo anëtar i bordit është individualisht përgjegjës për fushat që i janë ndarë në lidhje me rezolutat e bordit menaxhues.
3. Nëse ka dyshime për ndonjë çështje të lidhur me ndonjë vijë tjetër afarizmi, çdo anëtar i bordit menaxhues është i obliguar të sigurojë që me këto çështje do të merret i tërë bordi menaxhues.
4. Bordi menaxhues duhet të informohet rregullisht për zhvillimet në linjat individuale afariste nga anëtarët e bordit menaxhues që e kanë përgjegjësinë përkatëse.

Neni 45 - Mbledhjet e bordit menaxhues

Çdo anëtar i Bordit Menaxhues thërret mbledhjet e bordit menaxhues, vendos rendin e ditës dhe kryeson mbledhjet. Ai ose ajo përcakton rendin sipas të cilit do të diskutohet rendi i ditës.

1. Mbledhjet e bordit menaxhues mund të mbahen në më shumë se një vend, duke u lidhur ndërmjet vete me audio konferencë ose video-konferencë, përderisa ata që janë të pranishëm të mund të identifikojnë pjesëmarrjen e të tjerëve dhe vendimet e tyre dhe të mund të përcjellin mbledhjen dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, si dhe të lexojnë, pranojnë ose dërgojnë dokumente që lidhen me ato pika (nëse ka).
2. Bordi menaxhues ka kuorum nëse të gjithë anëtarët kanë marrë ftesa dhe nëse së paku 2/3 e anëtarëve të tij marrin pjesë në miratimin e rezolutave. Anëtarët që mungojnë në bordin menaxhues mund të marrin pjesë në miratimin e rezolutave duke dorëzuar votat e tyre me shkrim, me telefon ose email. Votat e hedhura me telefon duhet të confirmohen me shkrim. Votat e dorëzuara më vonë llogariten si pjesëmarrje në miratimin e rezolutës. Ato pranohen vetëm nëse personi që e kryeson mbledhjen i pranon dhe vendos një afat të fundit për dorëzimin e tyre.
3. Rezolutat mund të miratohen jashtë mbledhjeve duke shpërndarë dokumentet ose në ndonjë formë tjetër (psh me telefon, me email ose me format tjera të miratimit elektronik). Nëse anëtarët e bordit menaxhues nuk kanë marrë pjesë në miratimin e rezolutave, ata duhet të informohen menjëherë për rezolutat e miratuara.
4. Bordi menaxhues duhet të përpiqet të sigurojë që rezolutat të miratohen në mënyrë unanime. Nëse nuk arrihet unanimiteti qështja do të sjellet tek vëmendja e kryesuesit të bordit të drejtorëve.
5. Duhet të mbahen procesverbalet e mbledhjeve të bordit menaxhues dhe të nënshkruhen së paku nga dy anëtarë të bordit menaxhues brenda 10 ditësh të punës pas mbledhjes. Një kopje e procesverbalit do t'i dërgohet menjëherë të gjithë anëtarëve të bordit menaxhues.

Neni 46 - Raportimi

1. MB do t'i japë bordit të drejtorëve dhe aksionarëve këto informata:
 - a. Dorëzimin e pasqyrave financiare tremujore të paaudituar të përgatitura sipas SNRF-ve duke përfshirë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e profitit dhe humbjes si dhe informatat për transaksionet

- financiare me kompanitë e ndërlidhura, të cilat pasqyra duhet të dorëzohen brenda 60 ditësh pas përfundimit të periudhës përkatëse të raportimit;
- b. Pasqyrat financiare vjetore të audituara që i përgatit bordi menaxhues sipas SNRF-ve dhe të auditohen nga auditorët me reputacion ndërkombëtar. Këto raporte duhet të dorëzohen sapo të përgatiten, por gjithsesi brenda 120 ditësh pas përfundimit të periudhës përkatëse të raportimit;
- c. Raportin tremujor të statusit që mbulon këto aspekte të veprimtarisë së bankës brenda 30 ditësh pas përfundimit të periudhës:
- i. Numri dhe vëllimi i kredive të financuara (mujore ose totale), numri dhe vëllimi i kredive që kanë mbetur;
 - ii. Ndarja dhe maturimi i kredive sipas vëllimit dhe numrit, duke përfshirë proporcionin e vonesës së kthimit, profilin e maturitetit, proporcionin e kthimit;
 - iii. Zhvillimet e depozitave duke përfshirë informatat e detajuara për rritjen e numrit dhe vëllimit të llogarisë rrjedhëse, llogarisë së kursimeve, depozitave të afatizuara dhe strukturës së maturitetit të depozitave;
 - iv. Indikatorë tjerë të rëndësishëm siç janë proporcioni i mjaftueshmërisë së kapitalit, proporcioni i likuiditetit, indikatorët e profitabilitetit, cilësia e pasurive, përbërja e pasurive, pajtueshmëria me rregulloret e kujdesit.
- d. Njoftimin e ngjarjeve apo rrethanave që mund të kenë efekt material dhe negativ në afarizmin apo veprimtarinë e bankës;
- e. Njoftimin për udhëzimet kryesore ose paralajmërimet që i merr banka nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, autoritetet tatimore, gjykatat ose agjencitë tjera rregullative, ose masat tjera të marra nga këto institucione përkitazi me bankën;
- f. Letrat e menaxhmentit nga auditorët të cilët japin komente, përveç tjerash, për kontrollet financiare të bankës dhe sa janë adekuate ato si dhe për sistemet e kontabilitetit dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut, bashkë me një kopje të komunikimeve tjera që auditorët ia kanë dorëzuar bankës ose menaxhmentit të saj lidhur me sistemet financiare, të kontabilitetit dhe sistemet tjera, menaxhmentin dhe llogaritë;
- g. Informatat që i kërkojnë aksionarët ose drejtorët si dhe t'i lejojnë përfaqësuesve të aksionarëve që të vizitojnë cilëndo nga objektet e bankës dhe të kenë qasje në librat dhe regjistrat e llogarive;
- h. Brenda njëqind e njëzet (120) ditësh pas përfundimit të vitit financiar, raportet vjetore lidhur me zbatimin e kërkesave mjedisore të aksionarëve, duke përfshirë pa kufizime, edhe një shpjegim të shkurtër të portfolios së kredive të bankës, një përmbledhje të çështjeve materiale mjedisore lidhur me portfolion e kredive dhe investimeve të bankës dhe një raport nëse banka apo klientët e saj i nënshtrohen ndonjë padie të lidhur me ambientin ose hetimeve të natyrës së procedurës gjyqësore;
- i. Menjëherë për të gjitha ndryshimet materiale për të plotësuar kërkesat për likuiditet, klasifikimin e kredive dhe kërkesat për provizione, kërkesat për kapital të mjaftueshëm dhe kërkesat e thesarit; dhe
- j. Korrespondencën nga auditorët me bankën ose nga auditori i brendshëm i bankës për parregullsi nëse ato kanë ndodhur dhe kur të kenë ndodhur;
2. MB është përgjegjës për të siguruar që informatat të jepen me kohë dhe rregullisht, dhe që të gjitha informatat e dorëzuara të jenë precize dhe të plota.

Pjesa IV - Komisionet

Neni 47-Komisioni i auditimit, komisioni i menaxhimit të riskut dhe komisionet tjera

Komisioni i Auditimit

1. Bordi i Drejtorëve duhet të themelojë komisionin e auditimit që përbëhet nga së paku tre anëtarë. Shumica e anëtarëve të cilën janë zgjedhur duhet të jenë anëtarë jo-ekzekutivë të bordit të drejtorëve. Të paktën një anëtar duhet të jetë ekspert i pavarur i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose të auditimit. Anëtarët e komisionit të auditimit emërohen nga Bordi i drejtorëve.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të komisionit të auditimit janë këto:
 - a. të vendosë rregullat e kontabilitetit dhe raportimit për bankën, të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të tilla dhe të inspektojë librat dhe ditarët e bankës përmes departamentit të auditimit të brendshëm të bankës;
 - b. të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve në fuqi dhe rregullores së bankave në Republikën e Kosovës nga ana e bankës;
 - c. të aprovojë rregulloret për departamentin e auditimit të brendshëm të bankës dhe të sigurojë funksionimin e departamentit të auditimit të brendshëm të bankës;
 - d. të sigurojë pavarësinë e departamentit të auditimit të brendshëm nga bordi menaxhues i bankës;
 - e. të rishikojë raportet tremujore të departamentit të auditimit të brendshëm, të aprovojë dhe prezantojë për bordin e drejtorëve dhe bordin menaxhues inspektimet dhe rekomandimet e auditimit;
 - f. të aprovojë planin vjetor të aktiviteteve që e përgatit departamenti i auditimit të brendshëm dhe të kryejë rishikimin tremujor të planit;
 - g. të mbikëqyrë aktivitetet e auditimit të brendshëm, të sigurojë që ai të zbatojë planet tremujore dhe vjetore të aktiviteteve;
 - h. të vlerësojë aktivitetet e realizuara nga kryesuesi i departamentit të auditimit të brendshëm dhe auditorët individualë;
 - i. të vlerësojë aktivitetet e secilit punëtor të departamentit të auditimit të brendshëm duke marrë parasysh aftësitë e tyre profesionale dhe të punës dhe të marrë vendimet e duhura;
 - j. bashkë me bordin e drejtorëve dhe bordin menaxhues të bankës, të sigurojë bashkëpunimin e departamentit të auditimit të brendshëm me njësitë tjera strukturore të bankës;
 - k. t'i japë rekomandime bordit të drejtorëve për punësimin ose shkarkimin e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të departamentit të auditimit të brendshëm të bankës, si dhe për pagesën e atij personeli; dhe
 - l. të vendos për punësimin apo shkarkimin e personelit tjetër nga departamenti i auditimit të brendshëm dhe për pagesën e atij personeli.
2. Komisioni i auditimit do të takohet rregullisht një herë në tremujor dhe për raste të jashtëzakonshme kur thirret nga bordi i drejtorëve ose nga anëtarët e komisionit të auditimit. Vendimet duhet të merren unanimsisht dhe nuk lejohen abstenimet. Procesverbalet e mbledhjeve do të regjistrohen në mënyrë të tillë siç është përshkruar me rregullat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Komisioni i menaxhimit të riskut

1. Banka do të ketë një komision të menaxhimit të riskut që përbëhet nga të gjithë anëtarët e Bordit të drejtorëve.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit të menaxhimit të riskut janë si më poshtë:
 - a. monitorojë zbatimin e politikave dhe procedurave të bankës për menaxhimin e riskut, duke përfshirë efikasitetin dhe pavarësinë e funksioneve të menaxhimit të riskut brenda bankës;
 - b. monitorojë profilin e riskut të bankës, duke përfshirë kreditë, tregun, likuiditetin, pajtueshmërinë operacionale,
 - c. reputacionin, rreziqet ligjore dhe të tjera të bankës;
 - d. monitorojë pajtueshmërinë me këtë ligj dhe rregulloret dhe urdhrat më poshtë; dhe
 - e. përcjellë mendimet tek Bordi i drejtorëve për çdo çështje që i parashtrohet atij nga Bordi i Drejtorëve ose që komisioni dëshiron t'i adresojë.
3. Komisioni i menaxhimit të riskut duhet të takohet së paku çdo tre muaj dhe në raste të tilla të tjera siç parashikohet në këtë statut.
4. Banka gjithashtu do të ketë edhe ndonjë komision tjetër të kërkuar me ligj ose nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe do të rregullohet me aktet dhe rregulloret e brendshme të bankës.
5. Takimet e Bordit të Komisionit të auditimit dhe Bordit të Komisionit të menaxhimit të riskut do t'ëmbahen në zyrën e regjistruar të bankës ose në ndonjë vend tjetër që i konvenon dhe për të cilin arrihet marrëveshje nga të gjithë anëtarët.

Pjesa V - Sekretari

Neni 48 -Emërimi, përgjegjësitë

Sekretari i kompanisë do të emërohet nga MB dhe do të ketë për detyrë të regjistrojë veprimet dhe mbledhjet e aksionarëve dhe bordit të drejtorëve në një libër për atë qëllim dhe ta mbajë regjistrin e aksionarëve, regjistrat e konflikteve të interesit, të sigurojë që të dërgohen njoftimet për të gjithë aksionarët dhe drejtorët dhe që të kryhen regjistrimet e duhura në zyrën për regjistrim të bizneseve.

Pjesa VI - Përfaqësimi i bankës

Neni 49 - Dhënia e autorizimeve

Shefi ekzekutiv ose një nga zëvendësit e tij ose saj mund të japin autorizim të përgjithshëm komercial, duke dhënë autorizimin e plotë për të nënshkruar dhe autorizim të kufizuar të përfaqësimit të punëtorët e bankës ose të këshilltarët e jashtëm të bankës, me kusht që këto autorizime të deklarohen dhe që fuqia e përfaqësimit të jetë obliguese për bankën vetëm nëse deklaratat përkatëse bëhen bashkërisht nga dy anëtarë të cilëve u është dhënë autorizimi ose autoriteti i përfaqësimit për atë deklaratë. Të gjitha autorizimet e tilla dhe autoritetet e përfaqësimit që i jep shefi ekzekutiv ose zëvendësit e tij ose saj duhet të jepen me shkrim.

Neni 50 - Shpalosja e autorizimit për përfaqësim

Banka është e obliguar të shpalosë emrat e personave specifikë që kanë marrë autorizimin e plotë për të nënshkruar dhe fuqitë e kufizuara të përfaqësimit gjatë marrëdhënieve të tyre me palët, dhe të shpalosë emrat e personave specifikë që janë të autorizuar të nënshkruajnë në bankë, në pajtim me ligjin në fuqi.

Pjesa VII - Dispozita të ndryshme

Neni 51 - Mbajtja e fshehtësisë

1. Përveç nëse bordi i drejtorëve aprovon ndryshe, anëtarët e bordit të drejtorëve, bordit menaxhues dhe menaxherët tjerë dhe zyrtarët e bankës nuk përdorin, publikojnë, shpërndajnë dhe as shpalosin informatat e besueshme për aktivitetet, shpenzimet, marrëveshjet financiare ose kontraktore ose marrëveshjet tjera, transaksionet apo çështjet tjera të bankës për asnjë palë, përveç për menaxherët ose punëtorët e bankës që kanë të drejtë t'i dinë ato, nëse janë vënë në dijeni për ato informata. Ata duhet të bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të penguar publikimin ose shpalosjen e informatave të fshehta lidhur me këto çështje.
2. Dispozitat e mësipërme të mbajtjes së fshehtësisë nuk zbatohen për: (a) të gjitha informatat që konsiderohen si publike ose që kërkohet të shpalosen me ligjin në fuqi; (b) informatat që janë bërë publike përmes burimeve tjera (që nuk kanë të bëjnë me bankën).
3. Të gjitha informatat materiale që i janë shpalosur aksionarëve të bankës dhe të cilët sipas mendimit të bordit të drejtorëve, mund të ndikojnë në vendimet e aksionarëve për investime, duhet t'u shpalosen edhe aksionarëve tjerë në të njëjtën mënyrë.

Neni 52 - Detyrimi fiduciar

Çdo zyrtar, drejtor dhe anëtar i komisioneve ka detyrë fiduciare ndaj bankës. Në rastet kur është e duhur, detyrimet e tilla fiduciare do të përfshijnë detyrimin për të:

- a. Vepruar në besim të mirë për përfitim të bankës;
- b. Ushtruar fuqitë që i janë dhënë atij ose asaj në pajtim me interesin më të mirë të bankës;
- c. Dhënë konsideratën e duhur çështjeve që do të vendosen nga ai ose ajo;
- d. Evituar dhe shpalosur konfliktet aktuale dhe të mundshme ndërmjet interesave personale të tij ose saj dhe atyre të bankës;
- e. Ushtruar kujdesin e duhur dhe aftësitë në realizimin e funksioneve të tij ose saj;
- f. Siguruar që mundësitë afariste që lidhen me punën e bankës t'i jepen bankës dhe të mos shfrytëzohen për qëllimet e tij ose të të afërmeve të tij; dhe

- g. T'i trajtojë si konfidenciale të gjitha informatat që i merr gjatë realizimit të detyrave të tij ose saj.

Neni 53 - Konfliktet e interesit

1. Zyrtarët dhe anëtarët e komisionit të bankës nuk mund të bëjnë marrëveshje të vlerës më shumë se ekuivalenti i 0.15% të kapitalit të paguar të bankës plus rezervat dhe fitimet e mbajtura të bankës ose kompanive të shoqëruara të saj, pa aprovim nga bordi i drejtorëve. Drejtorët nuk mund të bëjnë marrëveshje të vlerës më shumë se 0.15% të kapitalit të paguar të bankës plus rezervat dhe fitimet e mbajtura me bankën ose të kompanitë e shoqëruara të saj, pa aprovim në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve. Për të evituar çdo dyshim, kjo nuk pengon hyrjen në marrëveshje standarde me të njëjtat kushte si ato që i ofrohen klientëve tjerë të bankës ose pranimin e beneficioneve të punëtorëve që janë paraparë në kontrata kur ato kontrata janë lidhur me miratim sipas procedurave të korporatës. Kjo nuk e pengon pjesëmarrjen në skemat aksionare të punëtorëve.
2. Ndalesa në paragrafin (1) më lart zbatohet për marrëveshjet me personat e ndërlidhur (duke përfshirë edhe bizneset ose korporatat në të cilat personat e përmendur në pjesën më lart kanë interes pronësie), të afërmit, dhe të afërmit e familjes së ngushtë të drejtorëve.
3. Personi nuk mund të zgjidhet si zyrtar, drejtor ose anëtar i komisionit as të kryejë funksionet e këtyre, nëse ai ose ajo është punëtor, zyrtar ose drejtor, ose ka interes financiar në ndonjë person që konkurren me bankën ose kryen biznesin e njëjtë ose kryesisht të njëjtë si edhe banka, ose nëse ai ose ajo vetë konkurren me bankën. Çdo zgjedhje që bëhet në kundërshtim me dispozitat e kësaj pjese do të jetë e pavlefshme.
4. Një drejtor ose zyrtar nuk do të angazhohet në aktivitete që drejtpërdrejt konkurrojnë me afarizmin e bankës dhe do të mbahet përgjegjës për dëmet që i shkaktohen bankës si rezultat i kësaj konkurrence.
5. Zyrtarët, drejtorët dhe anëtarët e komisionit do t'i shpalojnë bordit të drejtorëve dhe të regjistrojnë me shkrim interesin financiar që mund ta kenë lidhur me të mëposhtmet:
 - a. Konkurrencën e bankës në afarizëm;
 - b. Kreditorët e bankës;
 - c. Furnizuesit e mallrave dhe shërbimeve; dhe
 - d. Klientët afaristë.
6. Në paragrafin (5) më lart "interesi financiar" do të thotë çdo marrëdhënie materiale financiare, duke përfshirë pa kufizime interesin pronësor që e ka individ i ose anëtar i familjes së ngushtë të tij ose saj dhe që mund të shkaktojë që personi të favorizojë konkurrencën, kreditorin, furnizuesin ose klientin përkitazi me marrëdhëniet e tij me bankën.
7. Shpalojet e kërkuara me paragrafin 4 më lart do të bëhen nga çdo individ në kohën kur shfaqet interesi financiar ose në kohën kur individ i merr një post, anëtarësi ose punësohet në ndonjë mënyrë tjetër nga banka dhe prapë kur del në pah ndonjë çështje specifike lidhur me votimin. Zyrtari ose drejtori me konflikt interesi nuk do të votojë për çështjen në fjalë. Nëse zyrtari, drejtori ose anëtar i komisionit nuk arrin të bëjë shpalojen e kërkuar, ai ose ajo mund të mbahet përgjegjës për atë sa është dëmtuar banka si rezultat i kësaj. Kjo nuk paragjykon vendimet e bankës për të shkarkuar ose ndërmarrë masa disiplinore kundër individit që nuk e ka shpallur konfliktin e interesit.

Neni 54 - Detyrimet

Zyrtarët, drejtorët dhe anëtarët e komisionit do të bëjnë përpjekjet më të mëdha për të kryer detyrat e tyre dhe për të arritur interesat më të mira të bankës. Asgjëmangut të mësipërmes, asnjë zyrtar as anëtar i një organi të menaxhmentit nuk do të bartë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet nëse vendimi për të vepruar ose për të mos vepruar është marrë në besim të mirë, ka qenë rezultat i konsideratës apo informatave që kanë qenë në dispozicion në atë kohë, dhe lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e bankës.

Neni 55 - Dëmshpërblimi

Për aq sa lejohet me ligj dhe përveç në rast konflikti të interesave, neglizhencës së madhe ose sjelljes së keqe me qëllim, banka e dëmshpërblen zyrtarin, drejtorin apo anëtarin e komisionit që ka qenë ose është palë ose kërcënohet të bëhet palë e ndonjë rasti të kërcënuar, të pezulluar ose të kryer civil, ndonjë procesi gjyqësor apo padie (që nuk është ngritur nga banka), për arsye të faktit që ai ose ajo ka qenë zyrtar, drejtor ose anëtar komisioni i bankës, për shpenzimet (duke përfshirë shpenzimet ligjore të arsyeshme ku përfshihen edhe ato për specialist ndërkombëtare kur ka nevojë), gjykimet, gjobat dhe shumatat e paguara aktualisht dhe që ai ose ajo i ka krijuar në lidhje me atë rast, padi apo proces.

Pjesa VIII - Dispozitat përfundimtare

Neni 56 - Hyrja në fuqi

- 1 Ky statut hyn në fuqi pasi të jetë aprovuar me shumicë votash që përfaqësojnë 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit aksionar të lëshuar të bankës në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe pasi të jetë aprovuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
2. Kryesuesi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve do të konfirmojë me nënshkrimin e tij ose saj që ky statut është aprovuar si duhet.

Neni 57 - Ndryshimet në këtë statut

Ndryshimet në këtë statut kërkojnë shumicë votash që përfaqësojnë 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit aksionar të lëshuar të bankës në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve.

Neni 58 - Ligji në fuqi

Për të gjitha rastet që nuk janë rregulluar me këtë statut zbatohet ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 59 - Origjinalet

Ky statut është përgatitur në tri ekzemplarë origjinalë në gjuhën angleze. Teksti do të përkthehet në gjuhët tjera zyrtare që përdoren në Republikën e Kosovës.

Neni 61 - Gjuha prioritare

Teksti origjinal i këtij statuti hartohet në gjuhën angleze dhe përkthehet në dy gjuhët zyrtare (shqipe dhe serbe). Në rast se ka kontradikta ndërmjet versionit në gjuhën angleze dhe përkthimeve në gjuhët tjera, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Data: 16 gusht 2017

Vendi: Frankfurt am Main, Gjermani

Nënshkruar nga z. Borislav Kostadinov

Kryesues i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

ANEKSI 1 - Logo e bankës



ANEKSI 2 - Aktivitetet e mëposhtme nuk financohen:

- a) Prodhimi ose aktivitetet që përfshijnë format e dëmshme ose eksploatuese të punës së detyruar/punës së dëmshme nga fëmijët ¹, praktikat diskriminuese, ose praktikat që nuk i lejojnë punëtorët të ushtrojnë ligjërisht të drejtat e tyre të bashkimit në sindikata dhe marrëveshjeve kolektive;
- b) Prodhimi ose tregtia e produkteve ose aktivitetet që konsiderohen si ilegale me ligjet e shtetit pranues (dmth ato kombëtare) ose rregulloret ose konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, duke përfshirë pa kufizime edhe legjislacionin ose konventat që lidhen me mbrojtjen e resurseve të biodiversitetit ² -ose të trashëgimisë kulturore;
- c) Prodhimin ose tregtinë e armëve dhe municionit;
- d) Prodhimin ose tregtinë e pijeve alkoolike (duke mos përfshirë birrën dhe verën); e) Prodhimin në masë ose tregtinë e duhanit ³.
- f) Lojërat e kumarit, kazinotë dhe ndërmarrjet e ngjashme;
- g) Tregtia me produkte të shtazëve të egra ose me shtazë të egra, që rregullohet sipas CITES⁴;
- h) Prodhimi ose tregtia me materiale radioaktive (duke përfshirë edhe deponimin dhe trajtimin e mbeturinave radioaktive); bizneset apo aktivitetet që kanë të bëjnë me industrinë nukleare apo materialet nukleare⁵; Prodhimi ose tregtia ose shfrytëzimi i fibrave të azbestit ose produkteve që përmbajnë azbest⁶ ose
- i) produkte që përmbajnë bifenile poliklorure⁷;

1 Kjo përfshin çdo veprimtari që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore. Puna e detyruar do të thotë puna ose shërbimet që nuk kryhen vullnetarisht, ku individit detyrohet duke e kërcënuar me forcë ose me dënim. Puna e dëmshme e fëmijëve do të thotë punësimi i fëmijëve duke i eksploatuar ekonomikisht, ose që mund të jetë i rrezikshëm për fëmijët, ose të ndërhyjë me arsimimin e fëmijës, ose të jetë i dëmshëm për shëndetin e fëmijës, ose për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social. Për më shumë informata referojuni: IFC (shih IFC/MIGA deklarata e përbashkët e politikave për punën e detyruar dhe punën e dëmshme të fëmijëve); deklarata e ILO për parimet fundamentale dhe të drejtat në punë, dhe parimet e mishëruara në këto konventa: konventat e ILO 29 dhe 105 (puna e detyruar), 87 (liria e shoqërimit), 98 (e drejta për marrëveshje kolektive), 100 dhe 111 (diskriminimi); 138 (mosha minimale); 182 (format më të këqija të punës së fëmijëve);deklarata universale e të drejtave të njeriut.

2 Konventat relevante të biodiversitetit përfshijnë pa kufizime: Konventën për konservimin e llojeve migruese të kafshëve të egra (Konventa e Bonit); Konventën për kënetat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitat Waterfowl (Konventa e Ramsarit); Konventa për konservimin e natyrës së egër në Evropë dhe habitateve natyrore (Konventa e Bernit); Konventa për trashëgiminë botërore; Konventa për diversitetin biologjik.

3 Kjo nuk zbatohet për klientë / ndërmarrjet që nuk janë të përfshira nw njw masw tw madhe në këto aktivitete. "Nuk janw tw pwrfsHIRA nw masw tw madhe" do të thotë se aktiviteti në fjalë është ndihmëse për operacionet primare tw një klienti. Përrjashtime mund të bëhen me miratimin e IFC.

4 CITES: Konventa për tregti ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër. Lista e llojeve sipas CITES është në dispozicion nga IFC ose EBRD.

^c

⁵ Kjo nuk aplikohet për blerjen e pajisjeve mjekësore, paisjet pwr kontrollin e cilësisë (matjet) dhe çdo pajisje tjetër ku burimi radioaktiv është i parëndësishëm dhe / ose i mbrojtur në mënyrë adekuate.

6 Kjo nuk zbatohet për blerjen dhe shfrytëzimin e çimentos me azbest ku përmbajtja e azbestit është <20%.

7 Bifenilet poliklorure—një grup i kemikalieve shumë toksike. BP-të gjenden në transformatorët elektrikë me naftë, kapacitorët dhe ndërprerësit që datojnë nga vitet 1950-1985.

- j) Prodhimi ose tregtia me barna, pesticide/herbicide, kemikale, substanca shkatërruese të ozonit⁸ dhe substanca tjera të rrezikshme që i nënshtrohen ndalesave ose daljes nga përdorimi me rregullat ndërkombëtare⁹;
- k) Veprimtaria e prerjes së drurëve për qëllime komerciale ose blerja e paisjeve për prerjen e drurëve për përdorim primar në pyjet tropikale, prodhimin dhe tregtimin e drurit apo të ndonjë produkti tjetër pyjor të ndryshme nga pyjet me menaxhim të qëndrueshëm; l) Peshkimi me rrjeta në ambient detar duke përdorur rrjeta që kanë gjatësi më të madhe se 2.5 km; m) Transporti i naftës ose substancave tjera të rrezikshme në anije-cisterna që nuk i respektojnë kërkesat e organizatës ndërkombëtare detare (IMO)¹⁰; aktivitetet që përfshijnë
- n) Lëshimin e organizmave të modifikuar gjenetiki në ambientin natyror pa u dhënë miratimi nga autoritetet kompetente ose ku autoriteti përkatës ka deklaruar veten si GMO falas¹¹; o) Aktivitetet në tokën e zënë nga popujt indigjenë ose grupet e ndjeshme, ose afër tokës së tillë, siç janë tokat dhe rrjedhat e ujërave që përdoren për aktivitetet të jetës si kullosat e bagëtive, gjuetia ose peshkimi;
- p) Aktivitetet në zonat e mbrojtura të caktuara ose afër këtyre zonave, të cilat janë të mbrojtura me ligj kombëtar ose me konventa ndërkombëtare, vendet me interes shkencor, habitatet e llojeve të rralla ose të rrezikuara, dhe pyjet primare/të vjetra me rëndësi ekologjike¹²; q) Aktivitetet që mund të kenë ndikim negativ në vendet me rëndësi kulturore ose arkeologjike; r) Aktivitetet që lidhen me zhvendosjen e pavullneshme të njerëzve; s) Lëvizjet ndërkufitare të mbeturinave që janë të ndaluara me ligjin ndërkombëtar¹³; t) Ndërtimin e ujëvarave të vogla ujore pa vlerësim të duhur mjedisor; u) Prostitucioni dhe të gjitha aktivitetet për të cilat afarizmi primar lidhet me pornografi;
- v) eksplatinë të minierave të diamantit dhe komercializimin e diamanteve, kur vendi pritës nuk ka aderuar në marrëveshjen Kimberley (KPCS) ose marrëveshje të ngjashme ndërkombëtare mbi burimet e nxjerrëshme.

⁸ Substancat që e harxhojnë ozonin (ODS): Bashkëdyzime kimike që reagojnë dhe harxhojnë ozonin në stratosferë, duke pasur si rezultat 'vrmat e njohura të ozonit'. Protokollin e Montrealit i rendit në listë substancat që e harxhojnë ozonin dhe datat e synuara për zvogëlimin dhe heqjen e tyre nga përdorimi. Lista e bashkëdyzimeve kimike e rregulluar me Protokollin e Montrealit, që përfshin aerosolet, ftohësit, agjentët që krijojnë shkumë, tretësit, dhe agjentët për mbrojtje nga zjarri, bashkë me detajet e shteteve nënshkruese dhe datat e synuara kur duhet të dalin nga përdorimi, është në dispozicion nga IFC ose EBRD.

⁹ Lista e produkteve që janë duke dalë nga përdorimi ose që janë ndaluar është në dispozicion nga IFC ose EBRD. Dokumentet për referencë përfshijnë Rregulloren e BE (EEC) Nr 2455/92 lidhur me eksportin dhe importin e disa materieve kimike të rrezikshme, e ndryshuar; listën e konsoliduar të OKB-së të produkteve konsumimi ose shitja e së cilave janë ndaluar, tërhequr, kufizuar rreptë ose nuk janë aprovuar nga qeveritë; Konventën për procedurat e pajtimit paraprak në bazë të informimit për disa kemikalie të rrezikshme dhe pesticide në tregtinë ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për ndotësit organikë; Klasifikimin e OBSH të pesticideve sipas rrezikut.

¹⁰ Këto përfshijnë: cisternat që nuk i kanë certifikatat e kërkuara të MARPOL SOLAS (duke përfshirë pa kufizime, pajtueshmërinë me kodin e ISM), cisternat në listën e zezë të Bashkimit Evropian ose që janë të ndaluara me Memorandumin e Parisit për kontrollin e limaneve shtetërore (Memorandum i Parisit), dhe cisternat që duhet të dalin nga përdorimi sipas rregulloreve 13G dhe 13H të Aneksit i të MARPOL. Asnjë cisternë e vjetër më shumë se 25 vite nuk bën të përdoret.

¹¹ Për vendet operuese të BERZH: aktivitetet që përfshijnë lirinë e GMO në mjedis natyror duhet referuar BERZH-it dhe standardeve kundër Kërkesave të Performancës në fuqi.

¹² Dokumentet kryesorë për referencë janë udhëzimet e IUCN për zonat e mbrojtura.

¹³ Dokumentet referencë janë: Rregullorja e (KE) nr 1013/2006 e datës 14 qershor 2006 për transportin e mbeturinave; vendimi C(2001)107/Final i këshillit të OECD lidhur me rishikimin e vendimit C(92)39/Final për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mbeturinave që janë dedikuar për rikthim; Konventa e Bazelit e datës 22 mars 1989 për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe largimin e tyre.

ANEKS 3 - Bordi i Drejtorëve (informata të përgjithshme)

Emri dhe mbiemri	Adresa	Të dhënat e pasaportës
Z. Borislav Kostandinov – Kryesues i Bordit të Drejtorëve	Beethovenstr. 7, 600325 Frankfurt am Main Germany	Pasaportë bullgare, me numër: 381290699
Z. Marcel Zeitinger	Friedberger Landstr. 118A, 60316 Frankfurt am Main Germany	Pasaportë gjermane, me numër: C5HTG5ZKP
Z. Rainer Ottenstein	Heimchenweg 34, 65929 Frankfurt am Main Germany	Pasaportë gjermane, me numër: C5HKF1VKR
Z. Jordan Damchevski	Rr. Petar Cajkovski No. 17, 1000 – Skopje, Republika e Maqedonisë	Pasaportë maqedonase, me numër: B0165984
Z. Luan Gashi	Rr. Rexhep Krasniqi, Obj. A1, Llam. 3, Nr. 13, 10000 Prishtine Republika e Kosovës	Numri personal: 1003130670
Z. Ilir I. Aliu – Drejtor Gjeneral ProCredit Bank Kosovo Sh.A.	Lagje Marigona Residence p.n. 10000 Prishtinë Republika e Kosovës	Numri personal: 1176137653

ANEKSI 4 - Kapitali aksionar dhe aksionarët

	Struktura e kapitalit aksionar		Përqindja e aksioneve (%)
	Kapitali i paguar në EUR	Numri i aksioneve	
Aksionarët			
ProCredit Holding AG & Co. KGaA	61,346,210	12,269,242	100
Kapitali total i lëshuar	61,346,210	12,269,242	100

ANEKSI 5 - Lista e aktiviteteve - sipas klasifikimit të Agjencionit për regjistrimin e bizneseve në Kosovë

- 5263 Shitje tjera me pakicë
- 6512 Ndërmjetësimet tjera monetare
- 6521 Qiradhënia financiare
- 6522 Dhënie tjera të kredive
- 6523 Ndërmjetësime tjera financiare nec.
- 6711 Administrimi i tregjeve financiare
- 6712 Ndërmjetësimi për letra me vlerë dhe menaxhimi i fondeve
- 6713 Aktivitetet që janë ndihmë për ndërmjetësimin financiar nec.
- 7011 Ndërtimi dhe shitja e pronës së patundshme
- 7012 Shitblerja e pronës së patundshme vetanake
- 7020 Qiradhënia e pronës
- 7032 Menaxhimi i pronës së patundshme sipas kontratës ose me tarifë

Aktivitetet e lidhura me pronën e patundshme ndërmerren vetëm për atë që ato të jenë ndihmesë për aktivitetet financiare, për shembull për qëllim të zbatimit të sigurisë për një kredi ose për atë që ato të lidhen me objektet e vetë kompanisë.